Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/533
Datë: 01.12.2020

Në mbështetje të nenit 4 dhe 23 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës nr. 03/L-189, nenit 6 dhe 16 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë nr. 35/2014, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 01.12.2020 nxjerrë këtë:

## V E N D I M

1. **Riakreditohet** Qendra për Aftësim Profesional "Sauda", me adresë Rr. "Beteja e Koshares" në Pejë, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 01.05.2020 deri 30.04.2023, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

   1.1 **Parukeri**, Niveli IV sipas KKK me 34 kredi të AAP.
   1.2 Numri maksimal i kandidatëve për një grup trajnimi mund të jetë pesëmbëdhjetë (15) dhe gjatë një viti mund të krijohen deri në 2 grupe.

2. **Akreditohet** Qendra për Aftësim Profesional "Sauda", me adresë Rr. "Beteja e Koshares" në Pejë, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 01.12.2020 deri 30.11.2023, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

   2.1 **Grim**, Niveli III sipas KKK me 10 kredi të AAP.
   2.2 Numri maksimal i kandidatëve për një grup trajnimi mund të jetë dhjetë (10) dhe gjatë një viti mund të krijohen deri në 6 grupe.

3. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së Qendrës për Aftësim Profesional "Sauda" për riakreditim dhe akreditim dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi Rivalidimin e

kualifikimit, si dhe Raporti i ekipit të ekspertëve mbi Riakreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për Rivalidim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për Riakreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Qendrës për aftësim profesional "Sauda";
2. Arkivit të AKK.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar KD së AKK